



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:247805  
Datë: 19.01.2024  
Numri i dokumentit: 05216763

Ac.nr.137/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Q.U nga Prishtina, me vendbanim në Zvicër, të cilin e përfaqëson i autorizuari B.J, avokat në Prishtinë, rr. "...” ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” në Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari S.D, për kompensimin e dëmit material, vlera e kontestit: 1.956.00 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësit të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1608/15, i datës 23.10.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.01.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditësit Q.U nga Prishtina, me vendbanim në Zvicër, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1608/15, i datës 23.10.2020 VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1608/15, i datës 23.10.2020 ka vendosur si në vijim:

*“I.REFUZOHET NË TËRËSI e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Q.U nga Prishtina me të cilën ka kërkuar që “të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensoj dëmin material në shumën prej 1,956.00 € duke i’a njohur edhe përlllogaritjen e interesit në shkallë vjetore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë, së bashku me shpenzimet e procedurës në shumën prej 839.00 €”, si e pa bazuar.*

*II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”*

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e atakuar të shkallës së parë ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rigjykim në Gjykatën e shkallës së parë ose ta ndryshojë aktgjykimin dhe ta aprovojë kërkesëpadinë si të bazuar.

Të paditurës i është dërguar ankesa për përgjigje me datë 05.01.2021, mirëpo e njëjta nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 09.07.2015, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi me të cilën kanë kërkuar kompensimin e dëmit material, më konkretisht me arsye sikurse në padi, gjithashtu i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.1608/15, i datës 23.10.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 09.05.2015 rreth orës 22:50 në LL. afër Q.-së ka ndodhur një aksident trafiku i përcjellë me dëme të konsiderueshme materiale të veturës së paditësit. Kjo është vërtetuar edhe nga raporti i aksidentit me numër 15-AR-1663 të datës 09.05.2015 si dhe nga skica nga vendi i ngjarjes. Por kontestuese sipas Gjykatës së shkallës së parë në mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse i siguruari tek e paditura ishte përgjegjës për shkaktimin e aksidentit në fjalë apo kishte kontribuar në shkaktimit të aksidentit.

Për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadiës, gjykata e shkallës së parë sipas propozimit të autorizuarit të paditësit, në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën e komunikacionit të punuar nga eksperti D.Z me datën 10.12.2019. Nga ekspertiza e komunikacionit Gjykata ka vërtetuar se në aksidentin e datës 09.05.2015 janë përfshirë tri automjete, dhe atë automjeti “N.N.” i pa identifikuar, automjeti “B” i siguar tek e paditura dhe automjeti “C” në pronësi të paditësit Q.U. Aksidenti është shkaktuar atëherë kur ngasësi i automjetit “N.N.” i cili ka qenë duke lëvizur në shiritin e djathtë, duke mos pasur kujdes të shtuar gjatë ndërrimit të shiritit, kalon në shiritin e majtë të lëvizjes dhe papritur e godet automjetin “B” (i cili ka qenë duke lëvizur në shiritin e majtë) në këndin e pasmë të anës së djathtë. Më tej, si pasojë e goditjes nga automjeti “N.N.” automjeti “B” e humbë kontrollin e lëvizjes, kalon në shiritin e djathtë të drejtimit të

lëvizjes, ku me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet në këndin e pasmë të anës së majtë automjetin “C”, i cili ka qenë duke lëvizur në shiritin e djathtë të drejtimit të lëvizjes së automjeteve. Nga rrjedh se aksidenti ka ardhur si pasojë e moskujdesit të shtuar në komunikacion të ngasësit të automjetit “N.N.” i cili edhe i ka kontribuar këtij aksidenti. Ndërsa ngasësi i automjetit “B” si pasojë e goditjes nga automjeti “N.N.” e ka humbur kontrollin e lëvizjes duke goditur automjetin “C”, nuk i ka kontribuar këtij aksidenti. E po ashtu as ngasësi i automjetit “C” e që ishte paditësi nuk i ka kontribuar këtij aksidenti.

Tutje në arsyetim theksohet se ekspertizës së komunikacionit Gjykata ia fali besimin e plotë, ngase e njëjta përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si te drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore. Në rastin konkret Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në aksidentin në fjalë ku janë përfshirë tri automjete, paditësi ka pësuar dëm material për shkak të dëmtimit të automjetit të tij në vlerë prej 1,956.00 €, ashtu siç është vlerësuar nga ekspertiza teknike mbi vlerësimin e dëmit në automjetin motorik. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur se shkaktar i aksidentit ishte ngasësi automjeti ‘N.N.’ i cili në momentin kritik është dashur që t’i përshtatet kushteve të rrugës dhe të ketë kujdes të shtuar gjatë ngasjes respektivisht ndërrimit të shiritit, me qëllim të mos rrezikimit apo pengimit të pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion. Si e tillë e paditura nuk mban përgjegjësi në bazë të fajit mbi bazën e sigurimit të auto përgjegjësisë për kompensimin e dëmit material paditësit, pasi që është vërtetuar se ngasësi i automjetit “B” i siguruar tek e paditura nuk e ka shkaktuar aksidentin dhe as nuk ka kontribuar në shkaktimin e tij. Mbi këtë bazë gjykata edhe e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Vendimin për shpenzimet e procedurës e ka marrë konform nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, e drejta materiale është aplikuar drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Kjo Gjykatë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës paditëse gjen se edhe pse paditësi ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, ankesa i referohet në tërësi vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, andaj Gjykata ankimore nuk do të lëshohet më tutje lidhur me këtë pretendim ankimor, pasi që ka gjetur se nuk ekzistojnë shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as shkelje të tjera të cilat e bëjnë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të pa qëndrueshëm.

Në raport me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, Gjykata e Apelit gjen se ky pretendim është i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetshëm në provat që gjenden në shkresat e lëndës, për faktin se as për Gjykatën e Apelit nuk është kontestuese se me datën 09.05.2015 rreth orës 22:50 në LL., afër Q.-së ka ndodhur aksident trafiku, ku deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë kur automjeti N.N e ka goditur veturën “B” (e cila ka qenë e siguruar tek e paditura) e më pas si pasojë e kësaj goditje kjo veturë e ka humbur kontrollin e lëvizjes duke goditur automjetin “C” të cilin ka qenë duke e vozitur paditësi. Po ashtu faktin se aksidenti ka ndodhur kjo Gjykatë e

vërtetohet edhe nga raporti policor i cili gjendet në shkresat e lëndës, e i cili është administruar edhe si provë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë edhe për faktin se e njëjta ia ka falur besimin ekspertizës së komunikacionit, ku eksperti ka konstatuar se aksidenti ka ardhur si pasojë e moskujdesit të shtuar në komunikacion të ngasësit të automjetit N.N, i cili edhe i ka kontribuar këtij aksidenti, ndërsa ngasësi i automjetit “B” si pasojë e goditjes nga “N.N” e ka humbur kontrollin e lëvizjes duke goditur automjetin “C”, por që nuk i ka kontribuar këtij aksidenti, e as ngasësi i automjetit “C” që ishte paditësi nuk i ka kontribuar këtij aksidenti.

Kjo Gjykatë i vlerësoi pretendimet ankimore të palës paditëse lidhur me ekspertizën por këto pretendime nuk mund ti marrë si të themelta për arsye se edhe Gjykata e Apelit e pranon ekspertizën si të besueshme, profesionale dhe objektive dhe se mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit gjen mbështetje edhe në provat e tjera që gjenden në shkresat e lëndës, e të cilat qojnë në përfundimin definitiv se e paditura nuk ka përgjegjësi në rastin konkret që të shpërblejë dëmin paditësit. Po ashtu paditësi ka pasur mundësi që pranë Gjykatës së shkallës së parë të propozojë që të nxjerrët edhe një tjetër ekspertizë në qoftë se kjo ekspertizë ka qenë e pa pranueshme për palën paditëse.

Pra, Gjykata e Apelit në asnjë rast nuk e konteston faktin se aksidenti ka ndodhur dhe se dëmi është shkaktuar, mirëpo për tu detyruar e paditura që të shpërblejë dëmin atëherë fillimisht duhet të ekzistojë fajësia e saj në shkaktimin e dëmit. Në rastin konkret në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar fakti se aksidenti ka ardhur si pasojë e goditjes nga ana e automjetit “N.N” e që më pas edhe është shkaktuar aksident zingjir, ndërsa automjeti “B” që ka qenë i siguruar tek e paditura nuk ka qenë shkaktar i aksidentit, e me këtë rast nuk mund të konstatohet se ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit.

Neni 136 i LMD-së përcakton se: *“I. Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”*, neni 137 përcakton se: *“Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material), ndërsa neni 140 i LMD-së përcakton se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia.”*

Gjykata e Apelit duke i zbatuar dispozitat e ligjit material në rastin konkret nuk mund të vijë në një përfundim ndryshe nga ai i Gjykatës së shkallës së parë, për arsye se për tu aprovuar kërkesëpadia atëherë do të duhej të ekzistonte faji i të paditurës, dëmi do të duhej të vinte si pasojë e veprimeve të të paditurës dhe si pasojë e këtyre do të ekzistonte përgjegjësi për kompensimin e dëmit të shkaktuar, mirëpo në rastin konkret kemi një gjendje krejt tjetër ku në mënyrë të pa kontestueshme është vërtetuar se automjeti i cili ka qenë i siguruar tek e paditura nuk e ka shkaktuar aksidentin, e rrjedhimisht nuk ekziston fajësia e këtij aksidenti pasi që i njëjti si pasojë e veprimeve të një automjeti tjetër e ka goditur tani paditësin, e që kjo nuk ka ardhur as si pasojë e dashjes e as pakujdesisë së automjetit të siguruar tek e paditura.

Duke pasur parasysh këto fakte, Gjykata e Apelit vlerëson se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë nga ana e Gjykatës së shkallës së parë.

Në procedurën kontestimore, palët kanë për detyrë që të ofrojnë provat e nevojshme që ti bazojnë pretendimet e tyre, e meqenëse pra nuk është provuar se e paditura ka përgjegjësi, Gjykata e Apelit vendosi që ankesën e paditësit ta refuzoj si të pa themeltë ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.137/2021 me datë 16.01.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.